



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 740/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k., operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74155-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Lezhë-Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë-H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot, Laç- Patok, Balldre-B Juge 77.85 km*”, me fond limit 72.794.063 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k.
Lagja “Besëlidhja”, godina përballë Gjykatës Lezhë, Kati II, Lezhë

- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër
Lagja “3 Heronjtë”, Rruga “At Zef Valentini”, Shkodër
- Subjekte të interesuar:** “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.
Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Muzakët”, pallatet Vokshi, Hyrja I,
Kati 7, Tiranë
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. &
“Drini-1” sh.p.k.
Njësia Administrative Fan, Mirditë
- “Jubica” sh.p.k.
Rruga “Luigj Gurakuqi”, Kuklejt, nr.108, Shkodër
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-
Al” sh.p.k.
Lagja “Shemri”, Rruga Nacionale Shemri – Kukës, Km.2.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri”
sh.p.k.
Rruga “Maliq Muço”, Nd.6, Hyrja 4, Ap.14, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i
ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.
914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.
596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për
Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.06.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74155-06-08-2018, me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Lezhë-Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë-H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot, Laç- Patok, Balldre-B Juge 77.85 km”, me fond limit 72.794.063 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

II.2. Në datën 10.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 25.07.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k.	57.000.004 lekë, kualifikuar
2. BOE “Ouen” sh.p.k. & “Shpresa - Al” sh.p.k.	60.648.975 lekë, kualifikuar
3. “Jubica” sh.p.k.	63.300.000 lekë, kualifikuar
4. BOE “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k.	64.516.493 lekë, kualifikuar
5. “Pe-Vla-Ku” sh.p.k.	66.728.035 lekë, kualifikuar
6. BOE “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k.	69.152.691 lekë, kualifikuar
7. “Vllaznia Ndërtim I.S” sh.p.k.	72.202.485 lekë, kualifikuar

II.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. në datën 01.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertave të operatorëve të tjerë ekonomikë, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]1. KVO gjatë vlerësimit të ofertave të paraqitura është në shkëlqje të plotë të dispozitave ligjore të cituara më lart pasi ka kualifikuar si të rregullta ofertat e OE/BO me kryesues, Alb Shpresa,

Ouen, Jubica, AEK Munella, Pe-Vla-Ku. Arsyetojmë: AK në DT pika 3.1., ka kërkuar: 3.1. Kapaciteti ligjor/professional i operatorëve ekonomikë: “Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.” OUEEN shpk, nga verifikimi në ëeb e QKB te Ekstratit, rezulton se nuk ka te pasqyruar në rubriken Objektivin e Aktivitetit, objektin e prokurimit “Mirembajtje rutine dhe dimerore me performance”.

2. AK në DT, Kriteret e Vecanta, pika "d", ka kërkuar: “d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në process ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”

CURRI shpk, pjestar i bashkimit të operatoreve me OE ALB SHPRESA, për plotesimin e këtij kriteri ka përdorur të dhenat e shërbimit si familiar të ortakut në qytetin e Shkodrës dhe jo subjektit. Nga verifikimi në ëeb e QKB-se selia e këtij operatori ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake nr.10 pallati Bimbashi. Në rastin e bashkimit të operatoreve kjo kërkesë duhet plotësuar nga secili anëtar.

3. AK në DT, pika 2.2.3 dhe 2.2.4 ka kërkuar “Operatori Ekonomik nuk duhet të ketë detyrime të pashlyra të taksave dhe tatimeve në çfarëdo lloji niveli. Për këtë duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendor, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendor ku operatori ushtron aktivitetin për vitet 2017”.

ALB SHPRESA sh.p.k. NUK disponon vërtetim për shlyerjen e taksave vendor nga Bashkia Lezhë për vitin 2017. Nga verifikimi në Ekstratin Historik të subjektit rezulton se ka zhvilluar aktivitetin gjatë muajit Janar 2017, pranë Bashkisë Lezhë shih nr e ceshtjes CN-122094-01-17.

4. AK, në DT pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 ka kërkuar 2.3.3 “Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues teknik në licencën përkatëse, për kryerjen e të gjitha punimeve/shërbimeve në këtë objekt.

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij përveç Administratorit dhe Drejtuesit teknik, minimalisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune noteriale, libere pune dhe CV.

- 14 punonjës të pajisur me kontratë pune dhe kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve me profesionet si: shofer dhe manovrator për drejtimin e mjeteve të kërkuara me poshtë.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret dhe punonjësit e kërkuar me sipër janë të paangazhuar në kontratë të tjera.”

JUBICA sh.p.k. ka përdorur të njëjtin staf inxhinier dhe punonjës (shofer manovrator) edhe në kontratë të tjera si ajo “Q. Las-Koman, H/Berdice - Velipojë...Krye Bushat ...” me gjatësi 71.4 km. ALB SHPRESA sh.p.k. ka përdorur të njëjtin staf inxhinier dhe punonjës (shofer manovrator) edhe në kontratë të tjera si ajo “F. Dukagjin-Rr Kombit .. Krume-Q Rushi Plepa...”, me gjatësi 77.6

km, edhe "Peshkopi-Q Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben-Vasie" me gjatesi 35.4 km, si dhe pjesetari tjetër i bashkimit CURRI.

OUEN sh.p.k. ka përdorur të njëjtin staf inxhinierë dhe punonjës (shofer manovrator) edhe në kontratën tjetër si ajo "F. Dukagjin-Rr Kombit .. Krume-Q Prushi Plepa.... " me gjatesi 77.6 km si edhe operatori tjetër SHPRESA AL.

AEK MUNELA sh.p.k ka përdorur të njëjtin staf inxhinierë edhe në kontratën tjetër si ajo "U. Matit... Shpal.... Ura Repsit" 84.9 km, edhe në segmentin e KOMANIT me gjatesi 71.4 km. AEK MUNELLA shpk, dy punonjës të deklaruar si manovrator nuk janë punonjës të tij pasi ata nuk figurojnë në formularin E sig (listpagesa). Konkretisht Alfred Lleshaj dhe Viktor Tuci megjithatë ky ifundit ka kontratë nga data 01.01.2018, gjithashtu ka deklaruar të njëjtin staf edhe në kontratat e tjera.

5. AK në DT pika 2.3.7, ka kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe makineritë që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)	në pronësi ose me qira	Copë 5
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Mjet për vendosje parrakesh metalik (guardrails)i Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 3
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobeton, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontratë furnizimi për asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh për menaxhim trafikë	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori të paraqesë një deklaratë sipas shtojcës Nr.9. Deklarata e mesipërme është objekt verifikimi dhe kontrolli në çdo kohë deri në realizimin e plotë të kontratës.

-Për mjetet e siguruar me qira duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente në Shqipëri) çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(i vlefshëm). Mjetet të shoqërohen me kontratën noteriale përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës,(të deklarohet nga qiradhenesi që mjeti nuk i është dhënë me qira ndonjë subjekti tjetër) ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalët si dhe afati i saj dhe të mos jenë të nënshkruara përpara janarit të vitit 2018.

-Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

-Per mjetet borepastruese ne lejet e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te vecante).

OE, ALB SHPRESA Shpk, ka paraqitur si dokumentacion provues, per plotesimin e ketij kriteri, po keto mjetet, edhe ne kontrata te tera si ajo "F. Dukagjin - Rr Kombit...Krume – Q.Prushi Plepa...", me gjatesi 77.6 km, edhe "Peshkopi - Q. Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben-Vasie" me gjatesi 35.4 km, si dhe pjesetari teter i bashkimit CURRI.

OUEN, ka paraqitur si dokumentacion proves, per plotesimin e ketij kriteri, po keto mjete edhe ne kontrata te tjera si ajo "'F. Dukagjin - Rr Kombit...Krume – Q.Prushi Plepa...", me gjatesi 77.6 km si edhe operatori teter SHPRESA AL, madje kamioni vetshkarkues AA 861 EZ, i paraqitur ne kete procedure, ne segmentin tjeter 77.6 km eshte perdorur si borepastruese.

Kontrata e qerese per autobetoniere dhe kamion nuk eshte specifikuar nga qeradhenesi se nuk ka kontrate qeraje me subjekt jeter, kerkuar specifikisht ne DT nga AK.

JUBICA, ka paraqitur si dokumentacion proves, per plotesimin e ketij kriteri, po keto mjete edhe ne kontrata te tjera si ajo "Q. Lac - Koman, H/Berdice - Velipoje...Krye Bushat..." me gjatesi 71.4 km.

AEK MUNELLA, ka paraqitur si dokumentacion proves, per plotesimin e ketij kriteri, po keto mjete edhe ne segmentin e Komanit me gjatesi 71.4 km, per ilustrim kamioni MR 1555A.

Per ilustrim mjeti badibal eshte e njejta fature tatimore perdorur ne kontrata te ndryshme noterie per segmentin tjeter "Ura Matit... ' me gatesi 84.9 km. Autobetonjeria e paraqitur nuk ploteson kriteret e kerkuara pasi nuk eshte shoqeruar me dokumentacion per regjistrimin e saj ne regjistrat publik, pa leje, siguracion, certifikate e kontrollit teknik. Për mjetet e kontraktuara me qera nuk specifikohet se qeradhenesi nuk ia ka dhene nje subjekti tjeter me qera, kerkuar specifikisht ne DT. PE-VLA-KU, per plotesimin e ketij kriteri, konkretisht 2 kamiona vetshkarkues 8-12 ton ka paraqitur kontrate noteriale. Sipas dokumentacionit te mjeteve jane ne pronesi te subjekteve te shtetit Kosoves dhe gjate perpilimit kontrates, ky dokumentacion nuk ka vullen apostle. Kontratat e qerese te paraqitura per mjetet nuk pasqyrojne elemente te procedures FL dhe date te hapjes ofertes.

6. AK ne DT ka kerkuar, pika 2.3.7 "g" "Per mjetet borepastruese ne lejet e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te vecante).

JUBICA, per plotesimin e keti kriteri ka paraqitur kontrate qeraje me subjektin "Sterkaj", me date 05.07.2018, e afat 24 muaj nga lidhja e kontrates qerese per ta perdorur ne 4 segmente njekohesisht, cka do te thote se eshte e angazhuar edhe per procedura tjera. Mjeti nuk ploteson karakteristikat teknike te kerkuara, APV, pasi ne lejen e qarkullimit nuk e ka kete cilesim, te kerkuar ne DT. Ne referim te dates se nenshkrimimit, nuk ploteson gjithë kohen e kontrates me AK-ne.

AEK MUNELLA, mjeti i paraqitur si borepastruese me targa AA 293 HS, nuk ploteson karakteristika teknike te kerkuara, APV, pasi ne lejen e qarkullimit nuk e ka kete cilesim, te kerkuar, fakt i verifikueshem lehtesisht edhe nga fotot.

PE-VLA-KU, per plotesimin e ketij kriteri, konkretisht borepastruese me targa 06-848-CT ka paraqitur kontrate noteriale. Sipas dokumentacionit te mjetit eshte ne pronesi te subjektit ZUKA sh.p.k. te shtetit Kosoves dhe gate perpilimit kontrates, ky dokumentacion nuk ka vullen apostile.

ALB SHPRESA shpk ka perdorur te njejtin mjet, borepastruese me targe AA 845 PH dhe mjeti targe AA250PH edhe ne kontrata te tjera si ajo "F Dukagjin - Rr.Kombit...Krume - Q. Prushi

Plepa...” me gatesi 77.6 km, edhe "Peshkopi-Q Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben-Vasie" me gjatesi 35.4 km, si dhe pjesetari tjetër i bashkimit CURRI.

7. Neni 26/8/d të Rregullave të Prokurimit Publik citon "Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtes periudhe nuk është kontraktor/nenkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçante, jo më të madhe se 100 % të kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të leshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mesipër, fjala "periudhe" nënkupton kohezgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga casti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit."

PE-VLA-KU në referim të deklaramëve të tij për këto procedurë prokurimi dhe krahasimit me zërat e licencës, kontratat në proces kalojnë vlerën 100% të kufirit maksimal të licencës. Ky subjekt në dokumentacionin e ofertës ka deklaruar si nenkontraktor të tij subjekt "Vllazeria", deklaratë kjo jo në përputhje me nenin 75 të Rregullave të Prokurimit Publik, çka nënkupton qëllimi i kesaj oferte nuk është realizimi nga ana e saj por ofertim për llogari të paleve të treta.

8. Neni 74/2 të Rregullave të Prokurimit Publik citon "Për dorezimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elemente konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..."

Zërat e preventivit të ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatoreve "Alb Shpresa" shpk. & CURRI shpk, janë nënshkruar vetëm në emër të njerit operator të bashkimi dhe konkretisht ALB SHPRESA.

Bashkimi i operatoreve "OUEN" shpk dhe "SHPRESA-AL" shpk, në marrëveshjen e nënshkruar nuk ka përcaktuar elemente konkret të punës që do të realizojë/përmbushë secili prej anëtarëve, për rrjedhojë kjo marrëveshje nuk është në përputhje me nenin 74/2 të Rregullave të Prokurimit.

Bashkimi i operatoreve "AEK MUNELLA" shpk dhe "DRINI-1" shpk në marrëveshjen e nënshkruar nuk përcaktuar elemente konkret të punës që do të realizojë/përmbushë secili prej anëtarëve, për rrjedhojë kjo marrëveshje nuk është në përputhje me nenin 74/2 të Rregullave të Prokurimit.

9. Operoret Ekonomike gjatë përgatitjes së ofertave pjesë të tyre kanë edhe paraqitur deklaramë të rreme, konkretisht:

-OUEN nëpërmjet shtoiçes 7 ka bërë deklaramë të rreme për objektin e veprimtarisë. Për ky operator ka bërë deklaramë të rreme për qëllim kualifikimi lidhur me angazhimin e mjeteve pasi ato i ka përdorur si kapacitet edhe në segmente tjera. Të njëjtat deklaramë të rreme me qëllim kualifikimi ky operator ka përdorur për stafin drejtues dhe punonjësit manovrator + shofer.

- ALB SHPRESA, nëpërmjet deklaramës së taksave vendor ka bërë deklaramë të rreme se ka likuiduar taksat vendore edhe për adresat ku ka ushtruar aktivitet. Për ky operator ka bërë deklaramë të rreme për qëllim kualifikimi lidhur me angazhimin e mjeteve pasi ato i ka përdorur si kapacitet edhe në segmente të tjera. Të njëjtat deklaramë të rreme me qëllim kualifikimi ky operator ka përdorur për stafin drejtues dhe punonjësit (manovrator + shofer), të njëjtat deklaramë edhe operatori tjetër i bashkimit subjekti "CURRI".

-"AEK-MUNELLA" ka paraqitur deklaramë të rreme me qëllim kualifikimi sa i përket mosangazhimit të mjeteve në kontratë të tjera. Gëithashtu ka mashtruar sa i përket disponueshmërisë vetëm për këto kontratë të stafit dhe manovrator. Ka paraqitur dëshmi për punonjës që nuk janë të kontraktuar nga ky subjekt, kjo rezulton nga verifikimi i formularave e sig 025A. Për ky operator mashtron me dokumenta dhe kraven evazion fiskal personelin e kontraktuar

nuk e ka te deklaruar ne formular e-siga. Te njejtat deklarime te rreme ka paraqitur edhe operatori tjetër i bashkimit subjekti “DRINI – 1”, sa i perket mjeteve, stafit, shoferave dhe manovratoreve, pasi I ka te angazhuar ne kontrata te tjera.

-JUBICA, ka bere deklarim te rreme per qellim kualifikimi lidhur me angazhimin e mjeteve pasi ato i ka perdorur si kapacitet edhe ne segmente tiera. Te njejtat deklarime te rreme me qellim kualifikimi ky operator ka perdurur per safin dreitues dhe punonjesit (manovrator + Shofer).

- PE-VLA-KU ka bere deklarim te rreme per permbushien e pikes "3.1" te DT “Kapaciteti ligjor”, nepermjet paraqitjes se shtojces 7 te DT, pjesë e ofertes.

10. AK ne DT, pika 2.3.9 ka kërkuar "Operatori Ekonomik duhet te disponoje dhe paraqese çertifikatat:

- ISO 9001:2008 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)*
- ISO 14001:2004 (për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)*
- OHSAS 18001:2007 (për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë)*
- ISO 39001: 2012 (për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor)”*

Ne Rekomandimin e Perbashket te APP dhe DPA drejtuar AK, pika 1 citohet: “1. Autoritetet kontraktore, duhet te mbajne ne konsiderate kete material orientues jo vetem gjate hartimit te kriterit per kualifikim mbi paraqitjen e certifikatave qe vertetojne kerkesat e cilesise, por edhe gjate procesit te vleresimit te ofertave te paraqitura ne nje procedure prokurimi, sa i takon hapave qe duhet te ndiqen per te verifikuar nese, nje certifikate e paraqitur ne nje procedure prokurimi nga operatore ekonomike eshte leshuar apo jo nga nje organ i vleresimit te konformitetit dhe nese, ky organ eshte akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.”

- ALB SHPRESA, nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikatat ISO te paraqitura ne kete procedure nuk jane te leshuara/akredituara nga organe te vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje jane certifikata fallso.

- CURRI nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikatat ISO te paraqitura ne kete procedure nuk jane te leshuara /akredituara nga organe te vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje jane certifikata fallso, ne periashtim te certifikates ISO 14001-2015.

- SHPRESA-AL, pjesetar e bashkimi “OUEN & SHPRESA-AL” nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikatat ISO te paraqitura ne kete procedure nuk jane te leshuara/akredituara nga organe te vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje jane certifikata fallso.

-JUBICA, nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikatat ISO te paraqitura ne kete procedure nuk janë të leshuara/akredituara nga organe te vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje jane certifikata fallso.

- MUNELLA, nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikata ISO 39001:2012 e paraqitur ne kete procedure nuk eshte e leshuara/akredituara nga organe te vleresimit te konformitetit te akredituar nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje kjo certifikata eshte fallso, gjithashtu edhe operatori tjetër pjesmarres si anetari tjetër i bashkimit perkoshem te operatoreve DRINI nuk ka te akredituar kete certificate (ISO 39001:2012).

- PE-VLA-KU, nga verifikimi ne sistem rezulton se certifikata ISO 39001:2012 e paraqitur në

kye procedure nuk eshte e leshuar/akredituar nga organe te vlersimit te konfirmimit te akredituara nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise, per rrjedhoje kjo certificate eshte fallso.

Sqarojme se nje certificate "ISO" te jete e leshuar/akredituar nga organe te vlersimit te konfirmimit te akredituara nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise duhet te kenë logon si më poshtë [...].



Data e akreditimit të organit lëshues

Sa më sipër kerkojmë:

- Refuzimin e ofertës së BOE “ALB SHPRESA & CURRI” pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat “2.2.3”; “2.3,4”; “2.3.7”; “2.3.7/g”; “2.3.9”; “1\ a”; “2/d”. Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzimin e ofertës së BOE “OUEN & SHPRESA - AL” pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat “1.a”; “3.1”; “2.3.4”; “2.3.7”. Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzimin e ofertës së BOE “AEK MUNELLA & DRINI 1” pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat “1/a”; “2.3.4”; “2.3.7”; “2.3.7/g”; “2.3.9”. Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzimin e ofertës së OE “JUBICA” pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat “2.3.4”; “2.3.7”; “2.3.7/g”; “2.3.9”. Ky operator për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzimin e ofertës së OE “PE-VLA-KU” pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat “2.3.7”; “2.3.1”; “2.3.7/g”; “2.3.9”; “2.3.10”; “2.3.11”; “3.1.shtojca 7”. Ky operator për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Thelimin e hetimit administrative për sa i përket dokumentacionit të paraqitur pjesë të ofertës nga këta operatorë.

- Pranimin e kërkesës së operatorit ekonomik “Iridiani” sh.p.k. Lezhë.

- Kthimin e përgjigjes brenda afateve.

II.5. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se nuk ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor. Ndërkohë që, sipas informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në datën 08.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës me nr. 329 prot., duke e refuzuar ankesën. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]Ajo cfare bie ne sy te Komisioni te Shyqrtimit te Ankesave, eshte fakti se ju dispononi informacion mbi cdo ofertues te perfshire ne kete procedure, ndonese neni 21/1 i LPP-se percakton te drejten per informim nepermjet paraqitjes se nje kerkese nga ana e subjektit te interesuar, per ti vene ne dispozicion informacionin qe AK administron. Ne rastin konkret ju nuk keni bere asnje kerkese te tille, ama informacionin e dispononi te detajuar. Ju jeni ne shkelje te hapur me ato cfare parashikon neni 57 pika 1 dhe 2 i LPP-se mbi administrimin e informacionit ne proces. Kjo ngre dyshime mbi menyren sesi ju keni ne administrim nje dokumentacion te tille. Per me teper qe edhe ankesa e paraqitur nga ana juaj nuk eshte bere ne emer te bashkimit mbi bazen e te cilit ju keni paraqitur oferten tuaj konkretisht: B.O "IRIDIANI" sh.p.k, kuote perfaqesimi 51% & "KOMBEAS", kuote perfaqesimi 49%. Sic shihet kufiri % ne pjesemarrje eshte thuajse i barabarte, si rrjedhim edhe ankesa duhet paraqitur e nenshkruar nga te dy operatoret. Nga sa me siper, vleresimi i bere nga KVO, per proceduren objekt ankimi, cilesohet i ligjshem, konform te gjitha kritereteve te kualifikimit. [...]

II.6. Në datën 13.08.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor. Konkretisht bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes pretendon:

1. *Bashkimi i perkohshem i OE ALB SHPRESA & CURRI*

- a. *Njeri nga pjestaret e BOE, konkretisht CURRI shpk nuk permbush kriterin e kerkuar pika 2/d te DT pasi si dokument per shlyerjen e detyrimeve te energjise ka paraqitur vertetimin si abonent familjar ne qytetin e Shkodres dhe jo si subjekt sipas te dhenave ne ekstrat e QKB-se "njesia bashkiake nr. 10 pallati Bimbashi".*
- b. *OE, ALB SHPRESA nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.2.3 te DT, dhe konkretisht nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Lezhe per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2017. Ka ushtruar aktivitetin ne kete njesi te qeverisjes vendore deri me date 24.01.2017, sipas deklarimeve ne QKB, CN-122094-01-17. Nga QKB gjejme edhe vendimin e asamblese se ketij subjekti date 23.01.2017 per ndryshimin e adreses sekondare*
- c. *BOE, ALB SHPRESA & CURRI nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.4 te DT, dhe konkretisht ka deklaruar te njejtin staf inxhenjerik, manovrator dhe shofer ne 3 kontrata te tjera si F.Dukagjin-Rr Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa...." me gjatesi 77.6 km, edhe "Peshkopi-Q.Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben -Vasie" me gjatesi 35.4 km, gjithashtu dhe pjesetari teter i bashkimit OE CURRI.*
- d. *BOE, ALB SHPRESA & CURRI nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7, 2.3.8 te DT, pasi te njejtat mjete jane te angazhuar njekohesisht edhe ne 3 segmentet e tjera si F.Dukagjin - Rr. Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa..." me gjatesi 77.6 km, edhe "Peshkopi-Q.Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben-Vasie" me gjatesi 35.4 km, gjithashtu dhe pjesetari jeter i bashkimi OE CURRI.*
- e. *BOE, ALB SHPRESA & CURRI nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7/g te DT, pasi borepastruset AA 845 PH dhe AA 250 PH jane te angazhuar njekohesisht edhe ne 3 segmentet e tjera si F.Dukagjin - Rr. Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa..." me gjatesi 77.6 km, edhe "Peshkopi-Q.Draje, Peshkopi Ushtelence, 52.7 km, edhe ne segmentin "Kuben-Vasie" me gjatesi 35.4 km, gjithashtu dhe pjesetari teter i bashkimi OE CURRI.*

- f. BO, ALB SHPRESA CURRI nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve shtojca 8 pikat "a" dhe "b" pasi preventivat e punime nuk jane nenshkruar nga te dy operatore pjesmarres ne perputhje me zerat e punimeve te marra persiper ne marrveshjen e bashkimit te perkoshem
operatoreve per kete procedure.
- g. BO, ALB SHPRESA nuk ploteson kriterin e kerkuar spas percaktimeve ne piken 2.3.9 te DT pasi certifikatat ISO te paraqitura, te leshuara nga KING CERT kane nje akreditim te pa njohur ne nivel kombetar e nderkombetar.
- h. BO, ALB SHPRESA & CURRI, nuk kane marre ne konsiderate paralajmerimet e AK te percaktuara ne DT duke perdorur deklarata te rreme per qellime kualifikimi dhe konkretisht ALB SHPRESA per likujdimin e taksave vendor, mos angazhimin ne segmente te tjera te stafit, mos angazhimin ne segmente te tjera te makinerive, mos angazhimin ne segmente te tjera te borepastruses. Gjithashtu OE CURRI ka te njeten situatë pasi ka bere deklarime te rreme per mos angazhimin e stafit, mos angazhimin makinerive dhe borepastruses ne segmente tjera.
2. Bashkimi i perkoshem i OE OUEN & SHPRESA-AL
- a. OE, OUEN, nuk perbush kerkesat e kerkuara ne piken 3.1 te DT pasi nuk ka te pasqyruar ne ekstratin e regjistrit objektin e prokurimit.
- b. BO OUEN & SHPRESA- AL nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.4 te DT, dhe konkretisht ka deklaruar te njejtin staf inxhenjerik, manovrator dhe shofer edhe ne 1 një kontrate tjeter F.Dukagjin - Rr. Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa..." me gjatesi 77.6 km.
- c. BO, OUEN & SHPRESA-AL, nuk permbush kerkesat e nenit 74/2 pasi nuk ka te detajuar elemente konkret te realizimit te puneve.
- d. BO, OUEN & SHPRESA- AL, nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7, 2.3.8 te DT, pasi ka perdorur te njejtat mjete te angazhuara edhe ne ne 1 kontrate tjeter F.Dukagjin - Rr. Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa..." me gjatesi 77.6 km.
- e. OE, OUEN, nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7/g, pasi mjeti kamion me targa AA 861 EZ i paraqitur ne kete procedure, eshte perdorur si borepastruesi edhe ne segmentin tjeter F.Dukagjin - Rr. Kombit...Krume-Q.Rushi Plepa..." me gjatesi 77.6 km.
- f. SHPRESA-AL nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.9 te DT pasi certifikatat ISO 39000 eshte e pa akredituar. Certifikatat e tjera te leshuara nga KING CERT kane nje akreditim te pa njohur ne nivel kombetar e nderkombetar.
- g. OUEN nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.9 te DT pasi certifikatat ISO 3834 dhe RS 800 nuk jane te akredituara.
- h. OE OUEN, nuk ka marre ne konsiderate paralajmerimet e AK e percaktuara ne DT duke perdorur deklarata te rreme per qellime kualifikimi ne shtojcen 7 per objektin e veprimtarise.
- i. BO, OUEN & SHPRESA-AL, ka bere deklarime te rreme me qellime kualifikimi sa i perket mos angazhimit ne kontrata te tjera te stafit drejtues, monovrator shofer, si dhe mjeteve, ne kundershtim te pikave 2.3.3.; 2.3.4 dhe 2.3.7 te DT.
3. Operatori Ekonomik JUBICA
- a. OE JUBICA nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.4 te DT, dhe konkretisht ka deklaruar te njejtin staf inxhenjerik, manovrator dhe shofer edhe ne kontraten "Q.Lac-Koman, H/Berdice-Velipoje...Krye Bushat..." me gjatesi 71.4 km.

- b. OE JUBICA nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7, ,2.3.8 te DT, pasi ka perdorur te njejtat mjete te angazhuara edhe ne kontraten "Q.Lac-Koman, H/Berdice-Velipoje...Krye Bushat..." me gjatesi 71.4 km.
 - c. OE JUBICA nuk ploteson kriterin e kerkuar spas percaktimeve ne njoftimin e kontrates pika 2.9 dhe piken 2.3.7. te DT pasi kontrata e dates 05.07.2018 e lidhur me subjektin Sterkaj eshte me afat 24 muaj nga nenshkrimi, cka nenkupton mos mbulimin e gjithë afatit kur DT percaktohet se afati fillon me nenshkrimin e kontrates me AK. Po kjo kontrate percakton se mjeti do te perdoret ne 4 segmente njekohesisht cka nenkupton se mjeti do te jete i angazhuar ne disa segmente/kontrata.
 - d. Mjeti i marre me qera me targa ADMT82 nuk ploteson karakteristika teknike si borepastruese pasi nga verifikimi ne dokumentat e mjetit nuk rezulton APV kerkuar ne DT pika 2.3.7/g.
 - e. OE JUBICA, ka bere deklarime te rreme me qellime kualifikimi sa i perket mos angazhimit ne kontrata te tera te stafit drejtues, monvrotor shofer, si dhe mjeteve, pikat 2.3.4 dhe 2.3.8 te DT.
4. Bashkimi i perkoshem i OE AEK MUNELLA & DRINI-1
- a. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pikat 2.3.3 dhe 2.3.4 te DT, dhe konkretisht ka deklaruar te njejtin staf inxhenjrik manovrotor dhe shofer edhe ne 2 kontrata tjera "U. Matit...Shpal...Ura Repsit" 84.9 km, edhe ne segmentin e Komanit me gjatesi 71.4 km.
 - b. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1, nuk permbush kerkesat e nenit 74/2 pasi nuk ka te detajuar elemente konkret te realizimit te puneve.
 - c. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve në piken 2.3.7 dhe 2.3.8 te DT pasi te njejtat mjete jane te angazhuar njekohesisht edhe ne 2 kontrata tjera "U. Matit...Shpal...Ura Repsit" 84.9 km, edhe ne segmentin e Komanit me gjatesi 71.4 km., per ilustrim mjeti MR 1555 A ose mjeti badipal eshte e njejta fature tatimore ne dy kontrata te ndryshme noteriale, duke mashtruar AK per qellime kualifikimi. E njejta situatë ligjore ka perdorur ne dy segmente te tjera sic eshte paisja greder ne seg e Komanit 71.4 km dhe Ura Matit...84.9 km, duke paraqitur kontrata noteriale te fallsifikuara, i njejti mjet ne dy kontrata te ndryshme noteriale.
 - d. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.7/a, pasi mjeti autobetoniere me goma (sipas fotos), nuk eshte i targuar dhe shoqeruar me leje qarkullimi, siguracion dhe certifikaten e kontrollit teknik.
 - e. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pike 2.3.7/a, pasi mjeti fadrome i blere me kontraten noterjale date 09.03.2017 me goma (sipas fotos), nuk eshte e targuar dhe shoqeruar me leje qarkullimi, siguracion dhe certifikate e kontrollit teknik dhe i perdorur edhe ne dy segmentet tjera, 71.4 km dhe 84.9 km.
 - f. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1, nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.3.3, pasi kontrata qe ka subjekti DRINI-1 me ing. e mjedisit znj.Silvana Hyka nuk eshte shoqeruar me Diplomen, libezen e punes dhe CV. Gjithashtu ky operator si pjese e BO nuk permbush detyrimin tij sipas % ne marreveshjen e formimit te bashkimit te operatoreve.
 - g. OE, AEK MUNELLA nuk ploteson kriterin e kerkuar spas specifikimeve ne pike 2.3.2 te DT pasi nuk ka paraqitur listpagesen e muajt Mars 2018 dhe po ky operator ka shkelje te nenit

119 te ligjit per procedurat tatimore pasi ka paraqitur si staf profesional (punonjes) te pa siguruar/deklaruar perpara organeve shteterore, konkretisht: Punonjesi Alfred Lleshaj eshte paraqitur si punonjes i kualifikuar "manovrator" nepermjet deshmise teknike, por nuk eshte i deklaruar/siguruar perpara organeve shteterore si dhe nuk ka kontrate punesimi, kjo rezulton nga listpagesat e paraqitura nga vete subjekti. Punonjesi Zef Bardhoci nuk eshte i deklaruar/siguruar per muajt Dhjetor 2017 dhe Janar 2018, megjithese ka paraqitur kontrate te rregull pune date 01.01.2018 e deshmi kualifikimi. Punonjesi Gezim Legisi nuk eshte i deklaruar/siguruar per periudhen Maj-Shtator 2017. Punonjesi Fran Lika nuk eshte i deklaruar/siguruar per periudhen Maj 2017. Punonjesi Viktor Tuci nuk eshte i deklaruar siguruar fare prane organeve perkatese shteterore, kjo ne baze te formulareve e sig te paraqitura nga subjekti, megjithese ka paraqitur kontrate te rregull pune date 01.01.2018 e deshmi kualifikimi.

- h. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pikat 2.3.7/a te DT, pasi mjeti i paraqitur si autobetoniere nuk eshte shoqeruar me dokumentacion regjistruar ne regjistrat publike, si leja e qarkullimit, siguracion, certifikate e kontrollit teknik.
 - i. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pika 2.3.7/c te DT, pasi mjetet, posedimin e te cilave e verteton me kontrate qeraje, nuk kane te specifikuar ne kete te fundit "qeradhanesi nuk ia ka dhene nje subjekti tjeter me qera".
 - j. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pikat 2.3.7/g te DT, pasi mjeti borpastrues AA 293 HS, nuk ploteson karakteristika teknike te kerkuara, APV.
 - k. BO, AEK MUNELLA & DRINI-1 nuk kane marre ne konsiderate paralajmerimet e AK e percaktuara ne DT duke perdorur deklarata te rreme per qellime kualifikimi, sa i perket mos angazhimit ne segmente te tjera te stafit, mos angazhimit ne segmente te tjera te makinerive, mos angazhimit ne segmente te tjera te borepastrues
 - l. Subjekti AEK MUNELLA nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pike 2.3.9 te DT pasi certifikata ISO 39 001 e paraqitur nuk eshte e leshuar/akredituar nga organet e vleresimit te akredituara nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Shteti Shqiptare.
 - m. Subjekti DRINI-1 nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pike 2.3.9 te DT pasi certifikatat ISO te paraqitura 9001; ISO 14001; OHSAS 18001, te leshuara nga AQS nuk e kane te vlefshem akreditimin nga DPA.
5. Operatori Ekonomik PE-VLA-KU
- a. OE PE-VLA-KU nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pike 2.3.11 te DT dhe konkretisht ky subjekt ka siguruar me ane te kontrates noteriale date 03.07.2018 me subjektin ZUKA COMPANY, si qeradhanes, borepastruesin me targa 06-848-CT, dokumentacion i cili nuk ka vulle apostile. E njejta situatë ligjore eshte edhe per 3 kamionat te marra me qera nepermjet kontrates dates 03.07.2018 me subjektin qeradhanes "JOOS & KRASNIQI-BAZE", dokumentacion i mjeteve nuk ka vulle apostile.
 - b. OE, PE-VLA-KU nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne pike 2.3.10 te DT, kontratat ne proces kalojne vleren 100% te kufirit maksimal te licenses.

- c. OE, PE-VLA-KU nuk ploteson kriterin e kerkuar spas percaktimeve ne pike 2.14.1. te DT, pasi operatori ka deklaruar se ne rast se shpallet fitues gjithe punimet do te realizohen nga nenkontraktori "VLLAZERIA", cka nenkupton ofertimin per llogari te paleve te treta.
- d. OE, PE-VLA-KU nuk ploteson kriterin e kerkuar sips percaktimeve ne pike 2.3.7/g, pasi borepastruesja me targa HS 0993A, marre me qera nga subjekti "Vellazeria", nuk eshte e shoqeruar me leje qarkullimi, siguracion, certificate kontrolli dhe nuk eshte APV.
- e. OE, PE-VLA-KU nuk ploteson kriterin e kerkuar sips percaktimeve ne pike 2.3.9 te DT pasi certifikatat ISO te paraqitura 9001; ISO 14001; OHSAS 18001 nuk jane te leshuara/akredituara nga organet e vleresimit te akredituara nga DPA ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Shteti Shqiptare. Keto certifikata jane te leshuara nga AQS me numer akreditimi 003, i cili nuk pasqyrohet ne faqen e internetit te Drejtorise se Pergjithshme te Akreditimit. Certifikata ISO 39001 nuk eshte e akredituar qe ne momentin e leshimit.

f. OE, PE-VLA-KU ka paraqitur deklarim te rreme per qellime kualifikimi ne deklaraten "shtojca 7" sa i perket objektit veprimtarise te njejte me prokurimin. Nga verifikimet ne ekstratin e subjektit nuk e gjejme te pasqyruar.

Sic provuam me lart AK ka kualifikuar, ne kundershtim me percaktimet e nenit 1, 2, 46, 53 te LPP, Rregullat e Prokurimit Publik, Ligjit nr.9920 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise". Ligjit nr.9632, date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendor", Rekomandimit te Perbashket te APP e DAP, DT, ofertat e paraqitura nga BOE "ALB SHPRESA & CURRI"; BOE "OUEN & SHPRESA-AL"; BOE "AEK MUNELLA & DRINI-1"; OE "JUBICA" dhe OE "PE-VLA-KU".

- Refuzoje ofertën e BOE "ALB SHPRESA & CURRI" pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat "a", "b" të paragrafit të fundit; "1.a"; "2/d, "2.2.3"; "2.3.4; "2.3.7"; "2.3.7/g"; "2.3.8"; "2.3.9". Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzoje e ofertën së BOE "OUEN & SHPRESA - AL" pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 7 pika e 1, shtojca 8, pikat "1.a"; "3.1; "2.3.3"; "2.3.4"; "2.3.7" "2.3.7/g"; "2.3.8";. "2.3.9". Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzojë ofertën e BOE "AEK MUNELLA & DRINI 1" pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat "a" dhe "b" të paragrafit të fundit; "2.3.2"; "2.3.3"; "2.3.4"; "2.3.7"; "2.3.7/a"; "2.3.7/c"; "2.3.7/g"; "2.3.8", "2.3.9". Ky bashkim operatorësh për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzoje ofertën e OE "JUBICA" pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT, Njoftimi i kontratës pikat "2.9" dhe "2.3.7"; shtojca 8, pikat "2.3.4"; "2.3.7"; "2.3.7/g"; "2.3.8"; "2.3.9". Ky operator për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Refuzojë e ofertën e OE "PE-VLA-KU" pasi nuk ploteson kërkesat për kualifikim te kerkuara në DT shtojca 8, pikat "2.3.7"; "2.3.7/g"; "2.3.9"; "2.14.1"; "2.3.10"; "2.3.11"; "3.1.shtojca 7". Ky operator për qëllime kualifikimi kanë paraqitur dëshmi të rreme si dhe dokumenta të fallsifikuara.

- Pranimin e kërkesës së operatorit ekonomik "Iridiani" sh.p.k. Lezhë.

II.7. NËPËRMJET shkresës nr. 357 prot., datë 24.08.2018, protokolluar me tonën në datën 29.08.2018, me objekt “*Kthim përgjigje*” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. me arsyetimin se: “*OE, PE-VLA-KU ka paraqitur deklaram te rreme per qellime kualifikimi ne deklaraten “Shtojca 7” sa i perket objektit të veprimtarise te njejte me prokurimin. Nga verifikimet ne ekstratin e subjektit nuk e gjejme te pasqyruar*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

b) *nuk është dënua për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

c) *nuk është dënua me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

d) *ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaraten e lartpërmendur.

III.1.2. Gjithashtu, në shtojcën 8 “*Kriteret e Vecanta të Kualifikimit*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “*Kapaciteti ligjor/professional*” përcaktohet se:

“Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.”

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojca 7, Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku deklarohet se ”Operatori ekonomik ”Pe-Vla-Ku” sh.p.k. është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. [...]”.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar” lëshuar më 07.06.2018, nga ku rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. është si vijon: *“Ndertime civile, projeksjon etj. Prodhim dhe tregetim te materialeve inerte, te produkteve te ndryshme prej betoni, si dhe materialeve te ndryshem per ndertim. Punime, prodhim dhe tregetim te materialeve prej duralumini dhe plastike. Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile industriale, veshje fasadash etj. Ndertim rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro etj. Ndertime ujesjellesa, gajesjellesa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore sistemim hidraulike dhe bonifikime. Prodhim dhe tregitim i materialeve inerte, produkteve te ndryshme prej betoni, si dhe materialeve te ndryshem per ndertim. Punime, prodhim dhe tregetim te materialeve prej duralumini dhe plastike. Punime elektrike dhe tregitim te materialeve elektrike, paisjeve elektrike, matesave elektrike etj. Perverc aktiviteve te pershkruar me siper, objekt i aktivitetit te shoqerise do te jete cdo veprimtari qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e pershtatshme per shoqerine, e cila nuk ndalohet nga ligji.”*

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konkretisht në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti ligjor/profesional”, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së saj. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ”Pe-Vla-Ku” sh.p.k. rezulton se ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, në të cilin nuk konstatohet të ketë si veprimtari mirëmbajtje dimërore të rrugëve, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

Akoma më tej, referuar ekstraktit të paraqitur nga ky operator ekonomik në të cilin konstatohet se (citojmë) *”Perverc aktiviteve te pershkruar me siper, objekt i aktivitetit te shoqerise do te jete cdo veprimtari qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e pershtatshme per shoqerine, e cila nuk ndalohet nga ligji”*, është një përcaktim që nuk përcakton apo jep detaje në lidhje me aktivitetin konkret që do të kryejë kjo shoqëri në të ardhmen. Referuar legjisllacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit, përcaktohet se regjistrimi i ndryshimit të fushës së veprimtarisë bëhet në bazë të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 43, ku çdo subjekt që kryen regjistrimin fillestar mbart gjithashtu detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të

dhënat e njoftuara dhe dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistër. Në rastin e ndryshimit të fushës së veprimtarisë, ky ndryshim duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar (duke paraqitur dokumentacionin përkatës si: Formulari i aplikimit; Dokument identifikimi aplikanti; Akti i përfaqësimit nëse aplikanti nuk është personi përgjegjës për aplikim). Në këtë legjislacion janë përcaktuar edhe hapat e procedurës së shtimit të objektit të veprimtarisë, të cilat janë lehtësisht të plotësueshme nga ana e cdo shoqërie, proces ky që përfundon brenda 1 dite nga ana e organit regjistruar, duke mos krijuar pengesa për secilin operator ekonomik të interesuar.

Sa më sipër, është detyrë dhe përgjegjësi e cdo operatori ekonomik që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me fushën e veprimtarisë së tij, veprimtari kjo që duhet të jetë lehtësisht e identifikueshme referuar procedurave të prokurimit ku marrin pjesë.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi nga ky i fundit nuk plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë në fushën e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. dhe “Kombeas” sh.p.k. qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & ”Kombeas” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k. me arsyetimin se: “*mjeti borpastruese AA 293 HS, nuk ploteson karakteristika teknike te kerkuara, APV*”, si dhe pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k. me arsyetimin se: “*Mjeti i marre me qera me targa ADMT82 nuk ploteson karakteristika teknike si borepastruese pasi nga verifikimi ne dokumentat e mjetit nuk rezulton APV kerkuar ne DT*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2.3.7 e “*Kapacitetit teknik*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“*2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe makinerite qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.*”

Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Lloji i Makinerive	Pronësia	Sasia
1	Mjet transporti vetëshkarkues (kamion 8-12ton)	në pronësi ose me qira	Copë 5
2	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Rrul vibrues	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Prerëse asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Asfaltoshtruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Mjet per vendosje parmakesh metalik (guardrails)i Batipal	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Borepastruese	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Kamioncine mbi 1 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
10	Fadrome 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 3
11	Ekskavator me zinxhir 0.4-1 m3	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Fabrike Asfaltobeton, e pajisur me QKL, leje mjedisore ose (kontrate furnizimi per asfaltobeton).	pronësi /qira/furnizim	Copë 1
13	Set semaforesh per menaxhim trafiku	pronësi /qira/furnizim	Copë 1

Operatori te paraqese nje deklarate sipas shtojces Nr.9. Deklarata e mesiperme eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe deri ne realizimin e plote te kontrates.

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë kur jane ne pronesi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi), çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm).*
- Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi duhet te paraqitet kontrata e blerjes, c’doganimi ne Shqiperi ose (kalimi ne regjim te perkohshme) dhe faturat tatimore perkatese.*
- Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet*

nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj dhe te mos jene te nenshkruara perpara janarit te vitit 2018.

- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 9. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Per sa ju perket mjetve borepastruese duhet te jene te paisura me kripore dhe thike (ku te komandohen nga brenda kabines nga manovratori) dhe (jo te jene te improvizuara si mjete borepastruese duke bere bashkim pjesesh per te improvizuar borepastruese).
- g) Per mjetet borepastruese ne lejet e qarkullimit te tyre duhet te jete e cilesuar si APV (automjet i perdorimit te vecante).
- h) Mjetet borepastruese duhet te shoqerohen minimalisht me nga dy foto ku te dallohen qartesisht edhe target e mjetit dhe pasijet e saj si kryporja dhe thika.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.3.2. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 2.3.7 autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

Pika 2.3.7 germa "c" tek kriteret e vecanta per kualifikim "Kapaciteti teknik", ishte kerkuar; Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi)çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshmëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj dhe te mos jene te nenshkruara perpara janarit te vitit 2018. Pika 2.3.7 germa "c" tek kriteret e vecanta per kualifikim "Kapaciteti teknik" ndryshon si me poshte;

Për mjetet e siguruara me qira duhet të paraqitet: dokumenti qe verteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi (leshuar nga autoritetet kompetente ne Shqiperi) çertifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (i vlefshmëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, (te deklarohet nga qiradhenesi qe mjeti nuk i eshte dhene me qira ndonje subjekti tjeter) ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "AEK Munella" sh.p.k. & "Drini – 1" sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Akt Marrëveshje për Bashkimin e Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë "AEK Munella" sh.p.k., shoqërisë "Drini – 1" sh.p.k., nga ku shoqëria "AEK Munella" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 51% të vlerës së përgjithshme të punimeve, dhe shoqëria "Drini – 1" merr përsipër të kryejë 49% të vlerës së përgjithshme të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "AEK Munella" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k. mbi disponimin e makinerive.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Drini-1” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruara sipas shtojcës 9, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “AEK Munella” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruara sipas shtojcës 9, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- Certifikaten e pronësisë së mjetit me targë AA293HS, në emër të shoqërisë “AEK Munella” sh.p.k. shoqëruar me Lejen e Qarkullimit, Certifikatën e Kontrollit Teknik, Siguracionin e mjetit dhe foto të mjetit.

III.3.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Jubica” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë e operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k. mbi disponimin e makinerive.
- Deklaratë e operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k. sipas së cilës makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- Kontratë Qeraje Nr.4865 rep., Nr. 1975 kol., datë 05.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Borëpastruese, me targë ADMT82, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë ”Sterkaj” sh.p.k. dhe qeramarrësit shoqëria ”Jubica” sh.p.k., me afat ”deri në përfundim të kontratave të cituara më lart me afta 24 muaj”.
 - Certifikatë e pronësisë së mjetit ADMT82, në emër të shoqërisë ”Sterkaj” sh.p.k..
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit

III.3.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato*

të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.3.7. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

III.3.8. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.3.9. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.3.10. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 54, pika 1/g, parashikohet:

“g) Automjetet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.”

Ndërsa në pikën 2 të po këtij neni parashikohet: “Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.”

III.3.11. Në VKM Nr.153 datë 07.04.2000 “Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 201 “Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)”, pika 2, parashikohet:

2. Klasifikohen, në baze të nenit 54, pika 2 e Kodit Rrugor, për përdorim të veçantë, automjetet e mëposhtme:

- a) traktori rrugor;
- b) autopastruesja;
- c) autopompa;
- ç) autopastruesja e bores;
- d) autoujitesja;
- dh) autooficina;

- e) automjetet e shkalles dhe automjetet për riparimin e linjave elektrike;*
- ë) automjetet me vinç gru;*
- f) automjetet për ndihmen e shpejte në rruge;*
- g) automjetet me pedane apo kosh të ngritshem;*
- gj) autobluajtesja shkoqese;*
- h) autofshiresja;*
- i) autoambulanca;*
- j) automjetet e varrimit;*
- k) autofurgonet e blinduar, për transportin e të burgosurve;*
- l) automjetet për dezinfektim;*
- m) autoreklammat dhe mjetet për ekspozime reklamash, të pajisura me karroceri të veçantë për kete funksion, që nuk lejon përdorime të tjera dhe ku sendet që transportohen nuk hiqen kurre nga mjeti;*
- n) automjetet për radio, televizion, kinema;*
- o) automjetet e caktuara për shfaqje në levizje;*
- p) automjetet e pajisura me ambulanca të levizshme;*
- q) autotendat;*
- r) automjetet e pajisura për sperkatje të fushave;*
- rr) autosaldatricja;*
- s) automjet me aparatura telegrafike;*
- sh) autogermuesja;*
- t) autoshpuesja;*
- th) autosharra;*
- u) automjetet e pajisura me gjenerator;*
- v) autopompa për beton;*
- z) automjetet e tjera të pajisura me vegla të njohura nga Ministria e Transportit, të përshtatshme për përdorim të veçantë.*

III.3.12. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.3.13. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kritereve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.3.14. Sa më sipër, KPP nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt ankimi, vëren se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit duhet të kenë në pronësi ose me qira 1 (një) borëpastruese, e cila duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Gjithashtu në dokumentat e tenderit është kërkuar që mjete borëpastruese në lejen e qarkullimit duhet të jetë e cilësuar si APV (automjet i përdorimit të veçantë). Në rastin konkret nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k. konstatohet se ky

i fundit në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, ku mjeti borëpastruese është paraqitur nga operatori ekonomik "AEK Munella" sh.p.k., i cili ka në pronësi mjetin dhe është shoqëruar me dokumentacionin përkatës për këtë mjet. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar për këtë mjet, konstatohet se në lejen e qarkullimit, tek "Të dhëna mbi identifikimin e mjetit", pika 1, "Lloji i mjetit", përcaktohet lloji "Kamion", ndërkohë që, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, është kërkuar shprehimisht që për mjetin borëpastruese në lejen e qarkullimit të tij duhet të përcaktohet lloji "APV" (automjet për përdorim të veçantë). Akoma më tej, referuar legjislacionit përkatës të kësaj fushe, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, dhe akteve në zbatim të tij, VKM-së Nr.153 datë 07.04.2000 "Për Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", është përcaktuar që borëpastruesja klasifikohet si "Automjet për përdorim të veçantë" pra "APV", kështu që rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me borëpastruesen, pasi në lejen e qarkullimit, të paraqitur për borëpastruesen me targë AA293HS, ky mjet rezulton "Kamion" dhe jo "APV". Gjithashtu, edhe në të gjithë dokumentacionin tjetër shoqëruar për këtë mjet, si certifikata e pronësisë së mjetit dhe certifikata e kontrollit teknik, ky mjet është cilësuar "Kamion". Sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "AEK Munella" sh.p.k. & "Drini – 1" sh.p.k. qëndron, pasi ky i fundit nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me borëpastruesen.

III.3.15. Për sa i përket pretendimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik "Jubica" sh.p.k. me arsyetimin se: *"Mjeti i marre me qera me targa ADMT82 nuk plotëson karakteristika teknike si borepastruese pasi nga verifikimi në dokumentat e mjetit nuk rezulton APV kërkuar në DT"*, Komisioni i Prokurimit Publik i qëndron të njëjtit arsyetim si në pikën III.3.14. të këtij vendimi, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "Jubica" sh.p.k., në përmbushje të kriterit për borëpastruesen, ky i fundit ka dorëzuar dokumentacionin për mjetin me targë ADMT82, ku në lejen e qarkullimit të të cilit nuk përcaktohet që ky mjet është "APV", sic kërkohet në dokumentat e tenderit dhe nga legjislacioni përkatës, si më lart cituar. Kështu që, rrjedhimisht pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik "Jubica" sh.p.k. qëndron, pasi ky i fundit nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor në lidhje me borëpastruesen.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "AEK Munella" sh.p.k. & "Dajti-1" sh.p.k. dhe operatorit ekonomik "Jubica" sh.p.k., qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë "AEK Munella" sh.p.k. & "Dajti-1" sh.p.k. dhe operatorit ekonomik "Jubica" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij për këta operatorë ekonomikë dhe gjendja faktike e juridike e këtyre operatorëve do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për

rrjedhje duke përmbushur kështu interesin e ankimesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.5. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. me arsyetimin se: “OE, OUEN, nuk përmbush kërkesat e kerkuara ne piken 3.1 te DT pasi nuk ka te pasqyruar ne ekstratin e regjistrimit objektin e prokurimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*

b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)*

b) *nuk është dënues për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,*

c) *nuk është dënues me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

d) *ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

III.5.2. Gjithashtu, në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti ligjor/professional” përcaktohet se:

“Objekti i Prokurimit duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.”

III.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k., rezulton se, është paraqitur dokumenti Marrëveshje Bashkim Operatorësh, ndërmjet shoqërisë “OUEN” sh.p.k. dhe shoqërisë “Shpresa-Al” sh.p.k., nga ku shoqëria “OUEN” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 89% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria “Shpresa-Al” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 11% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “OUEN” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

Konkretisht zërat e punimeve të preventivit referuar kontratës së bashkëpunimit dhe përqindjes së cituar më sipër janë ndarë si më poshtë vijon:

Shoqëria “OUEN” sh.p.k. do të realizojë konkretisht:

A. *Drenazhim dhe Pastrim;*

- *Nivelim i bankinave dhe mbushjeve ne nivelin fillestar*
- *Pastrimi karrezhatës nga aluvionet*

B. *Riparime të vogla në shtresa, Bankina dhe Struktura*

- *Sigurimi, shtrimi dhe ngjeshja e asfaltit me penetrim apo asfaltit të parapërgatitur, në gropat e përgatitura*
- *Shtrese binderi me granil guri kave, 4 cm, me makineri*
- *Sigurimi, shtrimi në gropa dhe ngjeshja e makadamit të lidhur me uje të aprovuar, për të krijuar shtresen baze të rruges*
- *Sigurimi, shtrimi ne gropa dhe ngjeshja e zhavorrit/granilit për të riparuar karrexhaten dhe bankinat.*
- *Mur guri mbajtës e themele, llac cemento M50*
- *Struktura monolite betoni C 20/25*
- *Sigurimi dhe lyerja me boje të bardhe të aprovuar të shenjave dhe strukturave rrugore*
- *Sigurimi dhe lyerja me ngjyra të përshtatshme të gureve të kilometrazhit tabelave drejtuese dhe shenjave të trafikut. Përfshi të gjitha figurat dhe germat.*
- *Tabele katrore normale me A=60*
- *Tabela trekendore normal me A=90*
- *Tabele rrethi "detyrim" normal me D=60*
- *Tabele trekendore normal me A-B, 90-30*
- *Guardrail H2 anesor me 2 valez, ne 1 ane, E5+ aksesoret*

Shoqëria "Shpresa - Al" sh.p.k. do të realizojë këto zëra punimesh:

A. *Drenazhim dhe Pastrim;*

- *Pastrim i kanaleve anesore te kullimit*
- *Pastrim i tobinove ekzistuese rrethore dhe katrore nga mbetjet sedimente apo bimet dhe prurjet e ngurta të depozituara*
- *Prerja, shkulja dhe pastrimi i bimesise se rritur ne zonen e rruges*

III.5.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik "OUEN" sh.p.k., si një nga anëtarët e bashkimit të përkohëshëm të shoqërive "OUEN" sh.p.k. dhe "Shpresa-Al" sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Shtojca 7 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ku deklarohet se "Operatori "OUEN" sh.p.k. është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. [...]"*
- *Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" lëshuar më 04.06.2018, nga ku rezulton se objekti i aktivitetit të shoqërisë "OUEN" sh.p.k. është si vijon: "Punime te zbatimit ne ndertim. Tregtimin me shumice e pakice, import-eksport te mallrave ushqimore, industriale, konfeksione, kinkaleri, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, paisje elektonike, vegla auto, veshmbathje, ilaçe, lende ndertimi, prodhime bujqesore e blektorale, lende te pare per industrine, pjese kembimi, makineri e paisje, kancelari, paisje zyrash, paisje shtëpiake dhe transport. Kryerjen e veprimtarive komisionere per llogari te te treteve. Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave per nevojat e vete shoqerise "OUEN"sh.p.k. dhe per te trete. Perpunim dhe shfrytezim i*

lendes se drurit. Mbjellje e fidaneve pyjore. Import - Eksport, shitje me shumice dhe pakice te lendes se drurit. Shitje dhe blerje automjetesh.”

III.5.5. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.5.6. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.*

III.5.7. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër.

III.5.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, konkretisht në shtojcën 8 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti ligjor/profesional”, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së saj. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “OUEN” sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive “OUEN” sh.p.k. dhe “Shpresa-AI” sh.p.k., rezulton se ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, në të cilin nuk konstatohet të ketë si veprimtari mirëmbajtje dimërore të rrugëve, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor.

III.5.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa - AI” sh.p.k. nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në

dokumentat e tenderit, pasi nga operatori ekonomik "OUEN" sh.p.k., si një nga anëtarët e bashkimit të përkohëshëm të operatorëve ekonomikë nuk plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë në fushën e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër.

Referuar legjislacionit në fuqi për regjistrimin e biznesit, përcaktohet se regjistrimi i ndryshimit të fushës së veprimtarisë bëhet në bazë të ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, neni 43, ku çdo subjekt që kryen regjistrimin fillestar mbart gjithashtu detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistër. Në rastin e ndryshimit të fushës së veprimtarisë, ky ndryshim duhet të regjistrohet në regjistrin tregtar (duke paraqitur dokumentacionin përkatës si: Formulari i aplikimit; Dokument identifikimi aplikanti; Akti i përfaqësimit nëse aplikanti nuk është personi përgjegjës për aplikim). Në këtë legjislacion janë përcaktuar edhe hapat e procedurës së shtimit të objektit të veprimtarisë, të cilat janë lehtësisht të plotësueshme nga ana e cdo shoqërie, proces ky që përfundon brenda 1 dite nga ana e organit regjistruar, duke mos krijuar pengesa për secilin operator ekonomik të interesuar.

Sa më sipër, është detyrë dhe përgjegjësi e cdo operatori ekonomik që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore në fuqi në lidhje me fushën e veprimtarisë së tij, veprimtari kjo që duhet të jetë lehtësisht e identifikueshme referuar procedurave të prokurimit ku marrin pjesë.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "OUEN" sh.p.k. & "Shpresa - AI" sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Iridiani" sh.p.k. dhe "Kombeas" sh.p.k. qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Iridiani" sh.p.k. & "Kombeas" sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë "OUEN" sh.p.k. & "Shpresa-AI" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij për këta operatorë ekonomikë dhe gjendja faktike e juridike e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë do të ndryshojë,

duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.7. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k. me arsyetimin se: *“OE, ALB SHPRESA nuk ploteson kriterin e kerkuar sipas percaktimeve ne piken 2.2.3 te DT, dhe konkretisht nuk ka paraqitur vertetim nga Bashkia Lezhe per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2017. Ka ushtruar aktivitetin ne kete njesi te qeverisjes vendore deri me date 24.01.2017, sipas deklarimeve ne QKB, CN-122094-01-17. Nga QKB gjejme edhe vendimin e asamblese se ketij subjekti date 23.01.2017 per ndryshimin e adreses sekondare”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”*, pika 2.2.3 e *“Kapacitetit ekonomik dhe financiar”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: *“2.2.3 Operatori Ekonomik nuk duhet kete detyrime te pashlyra te taksave dhe tatimeve ne cfaredo lloj niveli. Per kete duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet per vitet 2017, 2018.”*

III.7.2. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, *“Kriteret e vecanta të kualifikimit”*, *“Kapacitetit ekonomik dhe financiar”*, pika 2.2.3 autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:

Pika 2.2.3 tek kriteret e vecanta per kualifikim *“Kapacitetet ekonomike”*, ishte kerkuar: *“Operatori Ekonomik nuk duhet kete detyrime te pashlyra te taksave dhe tatimeve ne cfaredo lloj niveli. Per kete duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet per vitet 2017, 2018. Ne rastin e bashkimit te operateve seicili nga anetaret e grupit duhet ta paraqese kete dokument. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKR.”*

Pika 2.2.3 tek kriteret e vecanta per kualifikim *“Kapacitetet ekonomike”*, ndryshon si me poshte: *“Operatori Ekonomik nuk duhet kete detyrime te pashlyra te taksave dhe tatimeve ne cfaredo lloj niveli. Per kete duhet te paraqese një dokument që vërteton se ka plotësuar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore ku operatori ushtron aktivitet per vitin 2017.”*

III.7.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë, ndërmjet shoqërisë “Alb Shpresa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Curri” sh.p.k., nga ku shoqëria “Alb Shpresa” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 71% të vlerës së përgjithshme të punimeve, dhe shoqëria “Curri” merr përsipër të kryejë 29% të vlerës së përgjithshme të punimeve.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Alb Shpresa” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.7.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Alb Shpresa" sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Deklaratë e operatorit ekonomik "Alb Shpresa" sh.p.k. mbi pagesën e detyrimeve vendore për vitet 2014, 2015, 2016, 2017, 2018.
- Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar i shoqërisë "Alb Shpresa" sh.p.k., lëshuar nga QKB.
- Vërtetim Nr.113467/1 prot., datë 06.07.2016 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti "Alb Shpresa" sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore deri në vitin 2016.
- Vërtetim Nr.2961 prot., datë 20.04.2017 lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Lezhë me anë të të cilit vërtetohet se subjekti "Alb Shpresa" sh.p.k. ka likujduar detyrimet për taksat dhe tarifavat vendore deri më 31.12.2016.
- Vërtetim Nr.39111/1 prot., datë 27.03.2017 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti "Alb Shpresa" sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore deri në vitin 2017.
- Vërtetim Nr.116233/1 prot., datë 14.04.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti "Alb Shpresa" sh.p.k. ka likujduar detyrimet vendore për vitin 2018.
- Vërtetim Nr.T00395898 datë 30.06.2018 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti "Alb Shpresa" sh.p.k. rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 30.06.2018.

III.7.5. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës.*

Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi".

Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...",* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *"Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje".*

III.7.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.7.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.7.8. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se, në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës një dokument që vërteton se ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore, ku operatori ka ushtruar aktivitetet për vitin 2017. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., konkretisht, nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të Regjistrimit të kësaj shoqërie, rezulton se, kjo e fundit ushtron aktivitetet në Republikën e Shqipërisë me Zyrë Qëndrore në Tiranë, Rruga “Maliq Muco” sh.p.k., Ndërtesa 6, Hyrja 4, Ap.14, Njësia Bashkiake Nr.9, Kodi Postar 1016, si edhe referuar këtij Ekstraktit në pikën 14 *Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit* ushtron aktivitetet në disa adresa të tjera po në Bashkinë Tiranë. Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik të kësaj shoqërie, rezulton se për vitin 2017, kjo e fundit ka ushtruar aktivitetet në Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Lezhë, konkretisht në datën 24.01.2017 sipas ekstraktit, rezulton se është hequr adresa “Lezhë, Shëngjin” *Rikonstruksion i Rrugës Shëngjin-Kune, Zona Lezhës*, pra me anë të këtij ekstrakti rezulton se shoqëria “Alb Shpresa” sh.p.k. për vitin 2017 ka ushtruar aktivitetet edhe në Bashkinë Lezhë. Operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm ka dorëzuar vërtetime të lëshuara nga Bashkia Tiranë, më anë të të cilave vërtetohet se kjo shoqëri nuk ka detyrime të taksave dhe tarifave vendore të pashlyera në këtë Bashki për vitet 2016, 2017, 2018. Gjithashtu, operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k., ka paraqitur vërtetim se ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Lezhë për vitin 2016, por nuk ka paraqitur vërtetim nga kjo bashki për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2017, për sa kohë që nga Ekstrakti i kësaj shoqërie rezulton se ka kryer aktivitetet në Bashkinë Lezhë deri në datë 24.01.2017.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i ekstraktit historik të shoqërisë, të lëshuar nga QKB dhe vërtetimeve të lëshuara nga institucionet vendore të bashkive ku operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. ka ushtruar aktivitetet, rezulton se ky i fundit nuk ka vërtetuar se ka shlyer detyrime lidhur me taksat dhe tarifat vendore për vitet 2017 në të gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar, konkretisht për Bashkinë Lezhë.

KPP arsyeton se, duke qenë se sipas legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar, në përputhje me ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, të kryejë regjistrimet në regjistrin tregtar, të kryejë regjistrimin e subjekteve të përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e biznesit, për qëllim të regjistrimit fiskal, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të inspektimit të marrëdhënieve të punës, të lëshojë certifikata, ekstrakte të regjistrimeve dhe kopje të vërtetuara të akteve të depozituara, të publikojë të dhënat e regjistruara, sipas ligjit që rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lirë të publikut në to, atëherë

edhe verifikimi i vendeve ku shoqëria “Alb Shpresa” sh.p.k. ka kryer aktivitetin e saj gjatë vitit 2017 do të bëhet referuar ekstraktit të publikuar nga QKB për këtë shoqëri.

Sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Alb Shpresa” sh.p.k. si një nga anëtarët e bashkimit të përkohshëm të shoqërive, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2017, pra, rrjedhimisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k., nuk plotësojnë kërkesën e autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit në lidhje me shlyerjen e taksave vendore.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues qëndron.

III.8. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & ”Kombeas” sh.p.k. për kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Alb Shpresa” sh.p.k. & ”Curri” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar një nga pretendimet e tij për këta operatorë ekonomikë dhe gjendja faktike e juridike e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përbushur kështu interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. dhe “Kombeas” sh.p.k., bashkëngjitur dokumentacionit shtesë të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si pjesë të ankesës me nr. 1391 prot., ka dorëzuar edhe dokumentacion të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, konkretisht të operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k., operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k.

III.9.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ankimuesi, në ankesën dorëzuar pranë këtij të fundit ka dorëzuar dokumentacion që përbën sekret tregëtar dhe informacion konfidencial, në kuptim të nenit 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar, i cili disponohet vetëm në sistemin e prokurimeve elektronike.

Në nenin 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet se “Pa cenuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”. Referuar aktit administrativ nr. 329 prot., datë 08.08.2018 i lëshuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, trajtim i ankesës së palës ankimuese, konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në asnjë rast nuk ka marrë dijeni në formë zyrtare pranë autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentacionin e mësipërm, fakt ky i pranuar nga autoriteti kontraktor, ku *inter alia* sqaron se: “Ajo çfare bie në sy te Komisioni te Shqyrtimit te Ankesave, eshte fakti se ju dispononi informacion mbi cdo ofertues

te përfshirë në këtë procedurë, ndonëse nën 21/1 i LPP-se përcakton të drejtën për informim nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë nga ana e subjektit të interesuar, për të vënë në dispozicion informacionin që AK administron. Në rastin konkret ju nuk keni bërë asnjë kërkesë të tillë, ama informacionin e dispononi të detajuar. Ju jeni në shkelje të hapur me ato çfare parashikon nën 57 pika 1 dhe 2 i LPP-se mbi administrimin e informacionit në proces. Kjo ngre dyshime mbi menyrën sesi ju keni në administrim një dokumentacion të tillë. Për më tepër që edhe ankesa e paraqitur nga ana juaj nuk është bërë në emer të bashkimit mbi bazën e të cilit ju keni paraqitur ofertën tuaj konkretisht: B.O “IRIDIANI” sh.p.k, kuote përfaqësimi 51% & “KOMBEAS”, kuote përfaqësimi 49 %. Sic shihet kufiri % në pjesëmarrje është thuar se i barabartë, si rrjedhim edhe ankesa duhet paraqitur e nënshkruar nga të dy operatorët. Nga sa më sipër, vlerësimi i bërë nga KVO, për procedurën objekt ankimi, cilësohet i ligjshëm, konform të gjitha kriterëve të kualifikimit”.

Sa më sipër, KPP konstaton se, fshehtësia e procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, i parashikuar dhe nga *lex specialis*, shfaq një rëndësi të veçantë si në drejtim të mbrojtjes së nivelit më të lartë të interesit publik, por njëherazi shfaq edhe nivelin më të lartë të mbrojtjes së garancive procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në drejtim të ruajtjes së sekretit tregëtar, të dokumentacionit të dorëzuar nga këta të fundit në procedurat e prokurimit publik. Akoma më tej, KPP, gjykon se, cënimi i fshehtësisë së procesit të zhvilluar, për të cilin, pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik marrin dijeni në një formë të ndryshme nga ajo e caktuar në ligjin për prokurimin publik, mbi natyrën e kontratave të punësimi të stafit, llojit të tyre, listëpagesave të shoqërisë ku shfaqen të dhëna konfidenciale të punonjësit, numri i sigurimeve shoqërore, pagesa mujore (paga), lloji dhe natyra e kapaciteteve teknike të disponuara të konkurrentëve, cilësohet shkelje e sekretit tregëtar të kompanive, pasi, përhapet informacion konfidencial i subjekteve tregëtare tek persona të paautorizuar, informacion i cili, jo vetëm i shkakton dëm interesave tregëtare të shoqërive, por njëherazi cënon edhe procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.9.2. Të ndodhur në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, shqyrtimi i çështjes së mësipërme është jashtë kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nën 19/1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”. Sa më sipër, referuar materialeve të administruara në fashikullin e gjykimit, Komisioni i Prokurimit Publik, në zbatim të nën 13 të *lex specialis* i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Përsa më sipër, në mbështetje të nën 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nën 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & ”Kombeas” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74155-06-08-2018, me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “Lezhë-

Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë-H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot, Laç- Patok, Balldre-B Juge 77.85 km”, me fond limit 72.794.063 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini – 1” sh.p.k., operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa – AI” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë nga procedura e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ për konstatimet e mësipërme, si edhe të dërgohet pranë APP-së kopje e materialeve të administruara në shqyrtimin administrativ nr. 1391 prot., datë 13.08.2018.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & ”Kombeas” sh.p.k..
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1391 Protokolli

Datë 13.08.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Vilma Zhupaj (Anëtar) dhe znj. Lindita Skeja (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, përse i përket ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k., konkretisht nuk jemi dakord me arsyetimin në pikën III.1., III 2., III.3., III.4., III.5., III.6., III.7., III.8., si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k., operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-74155-06-08-2018, me objekt “*Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga "Lezhë-Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë-H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot, Laç- Patok, Balldre-B Juge 77.85 km*”, me fond limit 72.794.063 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetojmë

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Iridiani” sh.p.k. & “Kombeas” sh.p.k. (*thema decidendum*), konstatojmë se:

III.1.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit të shqyrtimit administrative nr. 1391 prot datë 13.08.2018 të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatohet se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, bashkëngjitur dokumentacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka dorëzuar edhe dokumentacion të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi, konkretisht të operatorit ekonomik “Pe-Vla-Ku” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k., operatorit ekonomik “Jubica” sh.p.k., bashkimit të operatorëve ekonomikë “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k. si më poshtë vijon:

- i. *Prova shkresore për vërtetimin e pretendimeve rreth BOE “Alb Shpresa” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k. konkretisht si : Certifikata ISO në emër të këtyre shoqërive, Deklarata mbi përcaktimin e drejtuesit teknik, Deklarata mbi angazhimin e stafit dhe punonjësve, Deklarata mbi disponimin e makinerive, Deklarata mbi angazhimin e makinerive, Certifikata kualifikimi të shoqërive, Marrëveshjen e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë etj (53 faqe)[...].*
- ii. *Prova shkresore për vërtetimin e pretendimeve rreth BOE “OUEN” sh.p.k. & “Shpresa-Al” sh.p.k. konkretisht: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, Deklarata mbi përcaktimin e drejtuesit teknik, Deklarata mbi angazhimin e stafit dhe punonjësve, Deklarata mbi disponimin e makinerive, Deklarata mbi angazhimin e makinerive, Diploma të stafit, Kontrata qeraje te mjeteve etj (23 faqe) [...]*
- iii. *Prova shkresore për vërtetimin e pretendimeve rreth BOE “AEK Munella” sh.p.k. & “Drini-1” sh.p.k. konkretisht: Listëpagesa, Kontrata pune të punonjësve, Deklarata mbi disponimin e makinerive, Deklarata mbi angazhimin e makinerive, Kontrata qeraje të mjeteve shoqëruar me dokumentacion për këto mjete, Certifikata kualifikimi të shoqërive etj (123 faqe)[...]*
- iv. *Prova shkresore për vërtetimin e pretendimeve rreth OE “Jubica” sh.p.k. konkretisht: Deklarata mbi përcaktimin e drejtuesit teknik, Deklarata mbi angazhimin e stafit dhe punonjësve, Deklarata mbi disponimin e makinerive, Deklarata mbi angazhimin e makinerive, Diploma të stafit, Kontrata qeraje të mjeteve etj (23 faqe) [...]*
- v. *Prova shkresore për vërtetimin e pretendimeve rreth OE “Pe-Vla-Ku” sh.p.k. konkretisht: Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, Deklarata mbi punët në proces, Kontrata qeraje të mjeteve shoqëruar me dokumentacion për këto mjete, Certifikata kualifikimi te shoqërive etj (45 faqe) [...]*

III.1.2. Konstatohet se ankimuesi, në ankesën dorëzuar pranë këtij të fundit ka dorëzuar dokumentacion sekret tregëtar në kuptim të nenit 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në nenin 25 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar parashikohet se “Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”. Referuar aktit administrativ nr. 329 prot., datë 08.08.2018 i lëshuar nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër, trajtim i ankesës së palës ankimuese, konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në asnjë rast nuk ka marrë dijeni në formë zyrtare pranë autoritetit kontraktor në lidhje me dokumentacionin e mësipërm, fakt ky i pranuar nga autoriteti kontraktor, ku *inter allia* sqaron se: “Ajo çfarë bie në sy të Komisioni të Shyqrtimit të Ankesave, është fakti se ju dispononi informacion mbi çdo ofertues të përfshirë në këtë procedurë, ndonëse neni 21/1 i LPP-së përcakton të drejtën për informim nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë nga ana e subjektit të interesuar, për ti vënë në dispozicion informacionin që AK administrojnë. Në rastin konkret ju nuk keni bërë asnjë kërkesë të tillë, ama informacionin e dispononi të detajuar. Ju jeni në shkelje të hapur me ato çfarë parashikon neni 57 pika 1 dhe 2 i LPP-së mbi administrimin e informacionit

në proces. Kjo ngre dyshime mbi mënyrën sesi ju keni në administrim një dokumentacion të tillë. Për më tepër që edhe ankesa e paraqitur nga ana juaj nuk është bërë në emër të bashkimit mbi bazën e të cilit ju keni paraqitur ofertën tuaj konkretisht: B.O “IRIDIANI” sh.p.k, kuotë përfaqësimi 51% & “KOMBEAS”, kuotë përfaqësimi 49 %. Siç shihet kufiri % në pjesëmarrje është thuarje e barabartë, si rrjedhim edhe ankesa duhet paraqitur e nënshkruar nga të dy operatorët. Nga sa më sipër, vlerësimi i bërë nga KVO, për procedurën objekt ankimi, cilësohet i ligjshëm, konform të gjitha kritereve të kualifikimit”.

Sa më sipër, konstatojmë se fshehtësia e procesit të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, i parashikuar dhe nga *lex specialis*, shfaq një rëndësi të veçantë si në drejtim të mbrojtjes së nivelit më të lartë të interesit publik, por njëherazi shfaq edhe nivelin më të lartë të mbrojtjes së garancive procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në drejtim të ruajtjes së sekretit tregëtar, të dokumentacionit të dorëzuar nga këto të fundit në procedurat e prokurimit publik. Akoma më tej, gjykojmë se cënimi i fshehtësisë së procesit zhvilluar, me anë të së cilës, pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit publik marrin dijeni në një formë të ndryshme nga ajo e caktuar në ligjin për prokurimin publik, mbi natyrën e kontratave të punësimit të stafit, llojit të tyre, listëpagesave të shoqërisë ku shfaqen të dhëna konfidenciale të punonjësit, numri i sigurimeve shoqërore, pagesa mujore (paga), lloji dhe natyra e kapaciteteve teknike të disponuara të konkurrentëve, cilësohet shkelje e sekretit tregëtar të kompanive, me anë të së cilit, përhapet informacion konfidencial i subjekteve tregëtare tek persona të paautorizuar, informacion i cili, jo vetëm shkakton dëm interesave tregëtare të shoqërive, por njëherazi cënon edhe procesin e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.3. Të ndodhur në këto kushte, konstatojmë se shqyrtimi i çështjeve të mësipërme është jashtë kompetencës lëndore të këtij të fundit. Referuar nenit 19/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”. Sa më sipër, referuar materialeve të administruara në fashikullin e gjykimit, Komisioni i Prokurimit Publik në zbatim të nenit 13 të *lex specialis* i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ në lidhje me konstatimet e mësipërme.

III.1.4. Akoma më tej gjykojmë se, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar ka paraparë një pozitë të veçantë për autoritetin kontraktor, duke e cilësuar këtë të fundit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij (*neni 12 pika 1*). Sa më sipër, gjykojmë se KPP nuk mund të vlerësojë mbi pozitën procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, kur vetë autoriteti kontraktor pranon dhe argumenton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues disponon informacion mbi çdo ofertues të përfshirë në këtë procedurë, ndonëse nga ana e autoriteti kontraktor nuk është dhënë asnjë informacion në lidhje me operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

III.1.5. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të

drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulohë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.”

III.1.6. Në nenin 30 “Kufijtë e shqyrtimit të ankesës” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, thuhet: “[...]Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë.

2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre [...]”.

III.1.7. Sipas nenit 31 pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor”, ndërsa në pikën 2 , gërma “a” thuhet se: “Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006 dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a)Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit [...]”.

III.1.8. Sa më sipër, gjykojmë se për shkak të shkeljeve të mësipërme të konstatuara procedura e mësipërme e prokurimit duhet anuluar, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se operatori ankimues në këtë procedurë prokurimi disponon gjithë dokumentacionin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës gjykojmë se referuar arsyetimit të mësipërm, për shkak të problematikës së shfaqur autoriteti kontraktor duhet të anulohë procedurën e mësipërme.

Theksojmë se, qëllimi kryesor i legjislacionit për prokurimin publik, si dhe i prokurimit në mënyrë elektronike, në veçanti, është ruajtja e të dhënave konfidenciale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Për sa kohë, nga dokumentacioni i administruar për këtë procedurë prokurimi, konstatohet në mënyrë të qartë që është shkelur detyrimi ligjor për ruajtjen e të dhënave konfidenciale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, fakt ky i pranuar dhe nga autoriteti kontraktor, KPP nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, kur ky i fundit në shkelje të rëndë të ligjit disponon informacion konfidencial

për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Rrjedhimisht, gjykojmë se kjo procedurë prokurimi duhet të anulohet, në zbatim të nenit 64, pika 2 gërma “ç” dhe nenit 24 gërma “dh” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parshikon se “*Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: dh) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin, sipas parashikimit të shkronjave “b” dhe “ç” të pikës 3 të nenit 64 të këtij ligji.*

Përsa më sipër, gjykojmë se të mos merret në shqyrtim ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Iridiani” sh.p.k. & ”Kombeas” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-74155-06-08-2018, me objekt “Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë rruga “Lezhë-Nënkalimi Milot, Lidhja e 2 urave-K/Pllanë - U.Zogut, Lezhë-H.Gjuetisë, Vain-Bilanc, U.Drojes-Milot , Laç- Patok, Balldre-B Juge 77.85 km”, me fond limit 72.794.063 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 10.07.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior Shkodër si dhe Autoriteti Kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Anëtar
Vilma Zhupaj**

**Anëtar
Lindita Skeja**